



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



AD/GJTHPR/36/21

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga L.I, ndaj gjyqtares V.L, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 24.09.2021 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga L.I, ndaj gjyqtares V.L, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

A r s y e t i m

Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 16.09.2021 ka pranuar ankesën përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nga L.I, i cili ankohet dhe është i pakënaqur ndaj Aktgjykimin A.nr.997/17 të datës 30.07.2021.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për shkelje disiplinore.

Autoriteti i kësaj gjykate, bazuar në faktet e çështjes ka konstatuar se nuk janë vërtetuar pretendimet e palës, pasi që në aspektin e çështjes së vendimmarrjes gjyqtari vepron duke e vendosur rastin, bazuar në prova-shkresa të lëndës dhe legjislacionit në fuqi. Ndaj vendimeve të gjykatës palës së pakënaqur i garantohet e drejta e shfrytëzimit të mjeteve juridike. Në marrjen e vendimeve nga gjykata përkatësisht nga gjyqtari nuk përbën shkelje disiplinore, është bindje e lirë e gjyqtarit për të vendosur çështjen. Ndërsa Autoriteti i kësaj gjykate lidhur me aneksen ndaj vendimeve të gjykatës nuk ka të drejtën e komentimit apo ndryshimit të vendimit gjyqësor.

Lidhur me pretendimet se gjyqtarja ka qenë e njëanshme në marrjen e vendimit, nuk është gjet bazë të mjaftuar për ti vërtetuar këto pretendimet.

Andaj, lidhur me parashtesën e ushtruar, në bazë të dhënave të përshkruara më lartë nuk ka gjet bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar KGJK-së kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
AD/GJTHPR/36/21, më datë 24.09.2021

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë